



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Illir Salihu	16.08.2023	28.08.2023	2023/0587

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 16.08.2023, OE **“AGEO & CO” SH.P.K**, Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: **2023/0547** lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Ri-tender Blerja e paisjeve teknike - Dron”** me nr. të prokurimit: **“210-23-6493-1-2-1”**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të kuotimit të çmimit, lloji i kontratës: furnizim.

Vlera e parashikuar e kontratës: 42,000.00 €.

Kriteri për dhënie të kontratës ishte: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Pretendimet e OE për dispozitat e shkelura:

Nenet: 1, 6, 7, 28, 54, 59, 60, 64, 72, 99 dhe 104 të LPP-së.

Në vazhdim janë paraqitur Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën e deponuar në OSHP nga OE ankues.

* * *

Të nderuar, autoriteti kontraktues na ka eliminuar me arsyetimin se nuk kemi prezantuar stafin gjeodet i diplomuar, nuk kemi ofruar garancion per paisjen 24 muaj nga prodhuesi ose dilleri i autorizuar, si dhe kemi cmim me te larte ne krahasim me OE-fitues.

-Diploma e prezantuar nga une personalisht Vllaznim Vuçitërna-gjeodet, eshte origjinali dhe e noterizuar dhe e vetmja qe ploteson kriterin kryesor ne tender ne kuptim te plotesimit te kerkesave ne te gjitha pikat e specifikave teknike te A.K. Ne FTD eshte kerkuar gjeodet i diplomuar, dhe ne kemi dorezuar diplomen e gjeodetit. Sikur te ishte kerkesa gjeodet me titull ose kualifikimin "inxhinier i diplomuar i gjeodezise", atehere do te ishte krejt tjeter kerkese, pasi qe do te cekej titulli i diplomes dhe arsyeja do te qendronte, por me kete rast kerkesa ka qene nje gjeodet me diplome dhe nuk ka qene kerkesa e kufizuar cfare diplome te kete (bachelor apo inxhinier i diplomuar) por vetem te jete i diplomuar, prandaj ajo duhet te pranohet si e tille pasi qe diploma eshte dhe gjeodeti eshte me diplome. Prandaj, me kete rast ne besojme se A.K. MMPHI ka bere shkelje te dyfishte per faktin se per tenderin e njejte heren e kaluar ne hapjen e dates 06.03.2023 me nr **210-23-858-1-2-1** ka qene e njejta diplome si dhe ka qene ne rregull ndersa ne hapjen e dyte nuk qenka ne rregull, prandaj edhe kerkojme qe pretendimi jone te pranohet si i bazuar.

-Ne FTD eshte kerkuar garancion nga prodhuesi ose dilleri i autorizuar sipas kushteve te fabrikimit, me kete rast ne kemi dorezuar garancionin e tille dhe eshte plotesisht konform kerkesave, pasi qe ne kemi kerkuar autorizim dhe garancion nga dilleri sipas kushteve te fabrikimit, dhe kushtet e fabrikimit jane elektrika dhe bateria. Ne garancion shkruan pjesa elektrike qe ka kuptimin e makines-aircraft, pasi qe komplet struktura eshte e ndertuar mbi elektrike dhe e ka ate kuptim, ndersa pjesa e baterise nuk ka te beje brenda dronit, cdo pjese e tij eshte me chip dhe instalim elektrik, pra nuk ka mekanike dhe hidrualike aty, prandaj edhe ne leter garantuese shkruan qe pjesa elektrike. Por per kete A.K. ka mundur te kerkoj edhe sqarim shtese dhe nuk do te ishte fundi i botes pasi qe ligji e lejon sqarimin e dokumentit te dorezuar, edhe pse ne kemi pasur Autorizim per dorezim te ketij tenderi dhe garancion, si dhe do te sqaronim kete.Njekohesisht vlene te permendet, se OE i shperblyer me kontrate ka garancion per paisjen e njejte sikurse ne qe kemi ofertuar, si dhe eshte nga i njejti diller, pra behet fjale per te njejten paisje nga i njejti diller, prandaj nuk ka logjike qe garancioni per OE fitues te jete ne rregull, ndersa per ne te mos jete ne rregull, pasi qe behet fjale per paisjen e njejte, si dhe prodhuesi dhe dilleri eshte i njejte, por vetem se ne kete rast ne kemi autorizim dhe garancion gjeneral, ndersa OE fitues nuk ka autorizim per kete tender (edhe pse nuk eshte kerkuar, por vetem po e sqarojme), por ka vetem garancion per serine e caktuar, prandaj kerkojme qe pretendimi jone te pranohet si i bazuar.

- Arsyetimi se kemi cmimin me te larte ne krahasim me OE fitues, tregon favorizimin direkt te nje OE komplet te papergjegjshem i cili ne vazhdimesi ju ka vene ne lajthim dhe mashtrim, gje e cila edhe denohet penalisht pasi qe e ka shkelur deklaraten nen betim kur per tenderin e njejte ka prezantuar referenca ne hapjen e pare, ndersa ne hapjen e dyte per te njejtin tender i largon ato, prandaj me poshte si vijon do te sqarojme tutje si ka bere mashtrim:

-Ne hapjen e dates 06.03.2023 me nr **210-23-858-1-2-1** OE fitues ka prezantuar referenca nga persona fizik Alban Ejupi (person krejtesisht jashte lemise, si me ble naj qytetar i thjeshte nje bankomat per shtepi ose nje aparat per rezonance ose ngajshem, privatisht ne shtepi!) dhe Agon

Blakaj (person fizik), te njehta referenca ne i kemi kontestuar dhe kemi kerkuar nga A.K. dhe OSHP (Ankesa 174/23) ti verifikoni dhe te kerkoni dokumente plotesuese (transfer bankar ose fature te rregullt tatimore me fletedergese), por ju nuk keni vepruar dhe keni injoruar teresisht kerkesen tone per kete), me pas i njehti OE ne kete tender te njehte (ri-tender) ne hapjen e dates 17.07.2023 me nr. **210-23-6493-1-2-1** me qellim humbjes se gjurmeve, i largon keto referenca nga lista e kontratave te prezantuara dhe shpallet fitues i pergjegjshem edhe pse ka manipuluar me letra. Shtrohet pyetja pse i ka larguar ato, meqenese na qenkan te verteta, si dhe si mund te vazhdoj ai te trajtohet barabarte kur vete e konfirmon se ato referenca nuk kane qene te verteta, si dhe vete ai largon ato, prandaj nuk ka logjike qe nje OE te drajtohet i pergjegjshem kur vete e konfirmon se ka manipuluar me letra, prandaj kerkojme qe pretendimi jone te merret si i bazuar.

-Njekohesisht duke u bazuar ne ate se referencat e personave fizik nuk mund te jene serioze, kemi kerkuar nga A.K.-ja qe te kerkoj nga OE qe plotesohet referenca e Arsim Kastrati (person fizik jashte lemise se kerkuar) me fature te rregullt tatimore dhe fletetransfere bankar, pasi qe A.K.-ja ka te drejte te beje kete dhe eshte e arsyeshme ne menyre qe trajtimi te jete dinjitoz dhe i barabarte dhe "ferplay" ashtu siq garantojne ligjet dhe Kushtetuta e Republikes se Kosoves per te gjithë pjesemarresit ne kete gare, ne te kunderten ne do te kerkojme sqarime shtese nga Administrata Tatimore e Kosoves, nese nje shitje tille eshte e regjistruar apo jo, prandaj kerkojme qe pretendimi jone te pranohet si i bazuar.



Rr. UÇK-së, Rahovec
Nr. tel: 049/102-434
gjeo.projekt@gmail.com

Lista e projekteve të realizuara nga GJEO-PROJEKT SH.P.K gjatë viteve 2022-2023

Nr	Titulli i Projektit	Autoriteti Kontraktues Pozicionimi i Kontratës	Fillimi dhe Përfundimi	Vlera	Përshkrimi i Projektit
1	Furnizim me Drona	Policia e Kosovës	2022-2024	81,180.00€	Kontrata dhe procesverbale
2	Furnizim me setin GPS Emlind RS2+	Çlirim Podvorica	2022	3,500.00€	Referenca
3	Furnizim me Instrument gjeodezik Leica 1103 plus dhe aksesoret shtesë	Alban Sinani	2023	2,000.00€	Referenca
4	Sistemi i navigimit autopilot dhe GPS RTK	Arsim Kastrati	2023	15,150.00€	Kontrata dhe Referenca
5	Furnizim me Instrument gjeodezik GPS FJDynamics FJD TRION V1	GEO&KADASTRI SH.P.K	2023	3,000.00€	Kontrata dhe Fatura
6	Furnizim me pajisje dhe softver	OJQ Akademia e Aftësive "SkillUp Academy"	2023	16,850.00€	Kontrata dhe Referenca
7	Furnizim me Instrument gjeodezik GPS FJDynamics FJD TRION V1	FST ENGINEERING SH.P.K	2023	4,000.00€	Kontrata dhe Fatura
	Totali i projekteve			125,680.00€	

GJEO-PROJEKT SH.P.K



Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “AGEO & CO SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ri-tender Blerja e paisjeve teknike - Dron” me numër të prokurimit: “210-23-6493-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor

Rr.UÇK-së,Rahovec
Nr.tel:049/102-434
gjeo.projekt@gmail.com

Lista e projekteve të realizuara nga GJEO-PROJEKT SH.P.K gjatë viteve 2022-2023

Nr	Titulli i Projektit	Autoriteti Kontraktues Pozicionimi i Kontratës	Fillimi dhe Përfundimi	Vlera	Personi Kontaktues	Përshkrimi i Projektit
1	Furnizim me Drona	Policia e Kosovës	2022-2024	81,180.00€	Artan Fejza	Kontrata dhe procesverbale
2	Furnizim me setin GPS Emild RS2+	Çlirim Podvorica	2022	3,500.00€	Çlirim Podvorica 043/973-528	Referenca
3	Furnizim me Instrument gjeodezik Leica 1103 plus dhe aksesoret shtesë	Alban Sinani	2023	2,000.00€	Alban Sinani 049/169-575	Referenca
4	Furnizim me Drone Parrot,softveri 3D Survey dhe softveri PIX4D Fields	Alban Ejupi	2022-2023	13,700.00€	Alban Ejupi 049/870-333	Referenca
5	Sistemi i navigimit autopilot dhe GPS RTK.	Arsim Kastrati	2023	15,150.00€	Arsim Kastrati 044/834-474	Referenca
6	Furnizim me drone DJI PHANTOM 4PRO,Dji Mini 3pro+Fly More Kid dhe seti i GPS Emild Reach RS2+	Agon Blakaj	2022-2023	11,394.00€	Agon Blakaj 049/487-411	Referenca
7	Totali i projekteve			126,924.00€		

-Te kontrata publike nga Autoriteti PK kemi kerkuar nga A.K.-ja qe OE te prezantoj reference ose raport te pranimit perfundimtar per komplet kontraten, per arsye se nuk ka arritur te prezantoj raport pranimi perfundimtar per komplet kontraten, por ka bashkangjitur profature per mallin e liferuar! Meqenese kontrata eshte kornize dhe afatin e realizimit e ka deri me 2024, ajo mund te jete ende ne realizim e siper (askush nuk e mohon faktin se kontrata eshte, por vetem se eshte ende ne realizim), prandaj edhe nuk mund te pranohet si e realizuar, pasi qe nuk eshte finalizuar ne teresi ende, si dhe nuk ka reference ose raport pranimi se eshte perfunduar ne teresi kontrata, por ka vetem nje pjese te realizuar sipas raportit te pranimit, ndersa shumica e kontrates eshte ende ne realizim e siper, ku edhe deshmohet nga urdheri i blerjes i prezantuar ng OE si dhe deshmite e preantuar nga ai ne kete tender.

Pra, krejt cfare ne kemi kerkuar nga A.K.-ja eshte qe te respektohet neni 9.1 dhe 9.2 i FDT i dosjes se tenderit per kerkesat e pershtatshmerise, pra te pranohen referencia ose raporte pranimi perfundimtar, e jo te pranohen Profaturat e prezantuar nga OE si referencia apo raporte te pranimit te mallit, pasi qe profatura nuk mund te jete deshmi se eshte realizuar liferimi, prandaj krejt cfare kerkojme ne eshte qe OE te kete reference ose raport pranimi pasi qe me FTD kerkohet ashtu. Prandaj kerkojme qe pretendimi jone te pranohet si i bazuar.

	Kapaciteti teknik dhe profesional	Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2	Operatori ekonomik duhet te ofroj deshmi se gjate tri viteve te fundit deri ne njoftimin per kontrate ka kryer me sukses furnizime të natyrës së ngjajshme, ne vlere jo me te vogel se 63,000.00 euro.	Operatori ekonomik duhet te ofroje listen e kontratave të ngjajshme të realizuara gjatë tri viteve të fundit deri në njoftimin per kontrate. E deshmuar me kopjen e referencave ose procesverbalet e pranimit përfundimtar të furnizimeve duke treguar vlerën , datën, dhe vendodhjen e projekteve të furnizimeve në lëmin e kërkuar ne vlere jo me te vogel se 63,000.00 euro. Lista duhet te dorezohet ne origjinal e nenshkruar dhe vulosur nga operatori ekonomik.

-Ndersa referencia e leshuar poashtu nga personi fizik Alban Sinani, nuk hyn fare ne kete kategori,

pasi qe eshte furnizim krejtesisht tjeter dhe jashte kerkesave te FDT me ate qe kerkohet me kete tender si pershtatshmeri.

-Ne shkresen e dates 26.07.2023 AK i kerkon OE GJEO-PROJEKT SH.P.K. te dorezoj nje dokument i cili eshte dashur te dorezohet para hapjes (katalogu i nenvizuar), ndersa A.K. ne cilesine e sqarimit shtese i tregon se mungese e ka dokumentin dhe i kerkon ta dorezoj, kjo eshte ne kundërshtim me LPP. Ndersa me pas ai perseri nuk e percjell katalogun e nenvizuar SIQ ESHTË KERKUAR, te cdo pozicioni ashtu siq eshte kerkuar me FTD, por e percjell nje katalog pershkrim copy-paste nga interneti (gje te cilen e kuptojme, pasi qe nuk ka kapacitet profesional te identifikoj sakte cdo pozicion te dronit Matrice 300, pasi qe eshte hera e pare si e shehe ketu ne tender). Ndersa me FTD ka qene e cekur ne menyre decitive se duhet te dorezohet katalog i nenvizuar per cdo pozicion te kerkuar sipas ST, prandaj kerkojme qe pretendimi te jete i bazuar.

	Kapaciteti teknik dhe profesional	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2	OE duhet të dorëzojë katalog për komisionin e vlerësimit dhe në pjesen e katalogut duhet të ketë të nenvizuar me ngjyrë për paisjen e kerkuar sipas kerkesës së AK.	OE duhet të dorëzojë katalog për komisionin e vlerësimit dhe në pjesen e katalogut duhet të ketë të nenvizuar me ngjyrë për paisjen e kerkuar.(origjinal jo kopje nga inetrneti)

-Sipas specifikave teknike OE fitues nga ju, nuk ka arritur te deshmoje-nenvizoj me katalog te nenvizuar:

saktesine e pozicionimit RTK me kompatibilitet me baze D-RTK2,

nuk ka arritur te deshmoje Airsense sistemin per identifikim te aeroplanëve te tjere,

nuk ka arritur te deshmoje rezolucionin e fotografive,

nuk ka arritur te deshmoje kendin e pamjes,

nuk ka arritur te deshmoje drejtimet 6 aksesh,

nuk ka arritur te deshmoje advanced dual operator mode ADC,

nuk ka arritur te deshmoje Airsense ADS-B Reciever.

Nuk ka arritur te deshmoje aksesoret e nevojshem per kete dron.

-Te pershkrimi i cmimeve, nuk eshte plotesuar ne rregull pasi qe te kolona ku duhet te shkruhet perqindja e vleres se TVSH %, ka shkruar vleren prej 4240.68, e nese njesia pa TVSH shumezohet me kete perqindje, del se shuma totale me TVSH eshte 999,075.37, shume e cila automatikisht e diskualifikon OE te shpallur fitues.te pranohet si ne rregull do te duhej te shkruhej 18, pasi qe norma tatimore e TVSH ne RKS eshte 18 %.Prandaj kerkojme qe pretendimi te jete i bazuar.

PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

NR. I ART	PËRSHKRIMI	NJESIA MATESE	SASIA	ÇMIMI PËR NJESI PA TVSH€	TVSH (%)	ÇMIMI PËR NJESI ME TVSH€	ÇMIMI TOTAL ME TVSH€	VENDI I ORIGINES
1	Furnizim me dron dhe Trajnimi i zyrtarit Për përdorim (procedurën e punës)	cope	1	23,559.32	4240.68	27,800.00	27,800.00	KINA
2								
ÇMIMI TOTAL ME TVSH							27,800.00 €	

Me kete rast nese e marrim per baze kerkesen e DT dhe ST, i vetmi OE qe ploteson kerkesat FDT dhe specifikave teknike jemi ne per faktin se kemi prezantuar dokumente te cilat permbushin 100% kerkesat e DT, perkatesisht ST-Specifikave Teknike, si dhe kemi prezantuar gjeodetin-trajnerin me referenca konkrete dhe fiks te prodhuesit DJI si dhe kemi prezantuar shitje fiks te serise se kerkuar DJI Matrice 300 me D-RTK dhe Dig Terra. Prandaj nese behet ekzaminimi, vleresimi dhe maten ne peshore ofertat e prezantuara, atehere e vetmja oferte serioze dhe e cila i ploteson kerkesat e DT , FDT dhe ST jemi ne.

Gjithashtu ne si operator ekonomik e kemi ofruar deklaraten ku e konfirmojme pranimin e specifikimeve teknike, dhe njekohesisht kemi dorëzuar të gjithë dokumentacionin e prodhuesit, prandaj rezulton se ne i kemi plotësuar kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë dhe jemi të vetmit të përgjegjshëm ne kuptim te kesaj dosje te tenderit.

Se si janë formuluar kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, është përgjegjësi e autoritetit kontraktues, mirëpo ne, ashtu siç është kërkuar i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Përfundimisht ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njekohesisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, sipas nenit 60 të LPP-së dhe poashtu jemi diskriminuar në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së. Prandaj krejt cfare ne kerkojme eshte trajtim te barabarte, e jo nje OE i papergjegjshem te shpallet fitues, nese nuk ka te pergjegjshem, atehere asnje te mos jete, e jo te favorizohet nje OE i caktuar e tjetri te diskriminohet.

Duke pasur parasysh nenin 1, 6 dhe 99 të LPP-së dhe Rregulloren e Punes 01/2020 Neni 4-plotesim i nenit 32, autoriteti kontraktues është dashur ti shfrytëzoj të gjitha dispozitat e LPP-së, edhe nëse ka pasur nevojë për sqarime shtesë është dashur të shfrytëzohen nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së, për të ardhur në një përfundim të saktë dhe real, sidomos kur kemi parasysh çmimin tonë të ofruar dhe mundësinë e ruajtjes së fondeve publike në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, e dihet se autoriteti kontraktues janë të thirrur për të shfrytëzuar fondet në mënyrë racionale, ekonomike, efikase dhe duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja, që të merr:

VENDIM

APROVOHET, ankesa e OE"AGEO & CO " SH.P.K si e bazuar, dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM**

dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, sqarimet e tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente dhe ne te gjitha instancat ligjore, per arsye se nuk jemi trajtuar barabart sipas LPP-se.

KRITERET PËR VLERËSIM

DOSJA E TENDERIT

	Kapaciteti teknik dhe profesional	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2	Operatori ekonomik duhet te ofroj deshmi se gjate tri viteve te fundit deri ne njoftimin per kontrate ka kryer me sukses furnizime të natyrës së ngjajshme, ne vlere jo me te vogel se 63,000.00 euro.	Operatori ekonomik duhet te ofroje listen e kontratave të ngjajshme të realizuara gjatë tri viteve të fundit deri në njoftimin per kontrate. E deshmuar me kopjen e referencave ose procesverbalet e pranimit përfundimtar të furnizimeve duke treguar vlerën , datën, dhe vendodhjen e projekteve të furnizimeve në lëmin e kërkuar ne vlere jo me te vogel se 63,000.00 euro. Lista duhet te dorezohet ne origjinal e nenshkruar dhe vulosur nga operatori ekonomik.
	OE duhet te ofroj garancion me shkrim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar per paisjen e ofruar.	OE duhet te ofroj deklarate me shkrim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar per garancionin e paisjes (dronit) sipas kushteve te fabrikimi (prodhimit)
	OE duhet të ketë staf një Gjeograf ose Gjeodet të diplomuar ose master, te kete pervoje pune se paku 3 vite pas diplomimi.	OE duhet te ofroj kopjen e diplomes të noterizuar ose origjinal per stafin e kerkuar, kontraten e punes ose parakontraten ne emer te ketij projektit, CV, ose referen qe deshmon per pervojen e punes.
	OE duhet të dorëzojë katalog për komisionin e vlerësimit dhe në pjesen e katalogut duhet të ketë të nenvizuar me ngjyrë për paisjen e kerkuar sipas kerkesës së AK.	OE duhet të dorëzojë katalog për komisionin e vlerësimit dhe në pjesen e katalogut duhet të ketë të nenvizuar me ngjyrë për paisjen e kerkuar.(origjinal jo kopje nga inetrneti)

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “AGEO & CO SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Ri-tender Blerja e paisjeve teknike - Dron**” me numër të prokurimit: “**210-23-6493-1-2-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor**



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry Of Environment, Spatial Planning and Infrastructure



DATE/A:	09.08.2023
PËR/ZA/TO:	AGEO & CO SH.P.K., L.Spitali Muharrem Fejza, Prishtine
Cc	Operatorët Ekonomik pjesëmarrës (OE)
Përmes	Izedin Bytyqi, zv. Sekretari i përgjithshëm - MMPHI
NGA/OD/FROM:	Ndriçim Mustafa, Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim për tenderin: Ri-tender Blerja e paisjeve teknike - Dron , me nr. të prokurimit: 210-23-6493-1-2-1

Ne zbatim të nenit 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik AGEO & CO SH.P.K., L.Spitali Muharrem Fejza, prishine Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “**Ri-tender Blerja e paisjeve teknike - Dron**”, me nr. të prokurimit : **210-23-6493-1-2-1**, të iniciuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me datën 13.02.2023, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës mori këtë :

VENDIM

MBI REFUZIMIN E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM E PARASHTRUAR NGA OE: AGEO & CO SH.P.K., L.Spitali Muharrem Fejza, prishine ., i datës 04.08.2023, SI TË PA BAZUAR.

- I. Refuzon kërkesën e “AGEO & CO SH.P.K., L.Spitali Muharrem Fejza, Prishtine”, Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “**Ri-tender Blerja e paisjeve teknike - Dron**”, me nr. të prokurimit : **210-23-6493-1-2-1**, të iniciuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me datën 13.02.2022.
- II. Vërtetohet: Njoftimi mbi Vendim i Autoritetit Kontraktues-MMPHI, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “**Ri-tender Blerja e paisjeve teknike - Dron**”, me nr. të prokurimit : **210-23-6493-1-2-1**, MMPHI-ja vazhdon më tutje me procedurën e prokurimit pas marrjes së vendimit për refuzimin e kërkesës si të pa bazë dhe vazhdimin e procedurave për këtë aktivitet të prokurimit.

ARSYETIM MBI REFUZIMIN

Operatori Ekonomik AGEO & CO SH.P.K., L.Spitali Muharrem Fejza, Prishtine, si pale e pakënaqur ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues me datën 03.08.2023, në formë elektronike, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-se për tenderin: "Ri-tender Blerja e paisjeve teknike - Dron", me nr. të prokurimit : 210-23-6493-1-2-1,, duke pretenduar se janë bërë shkelje të dispozitave të LPP-së, të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç janë:

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 28 i LPP-se
Neni 54 i LPP-se
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 64 i LPP-se
Neni 72 i LPP-së
Neni 99 i LPP-së
Neni 104 i LPP-se

Pretendimi 1:

Të nderuar, ju si autoritet kontraktues na keni eliminuar me arsyetimin se nuk kemi prezantuar stafin gjeodet të diplomuar, nuk kemi ofruar garancion për paisjen 24 muaj nga prodhuesi ose dilleri i autorizuar, si dhe kemi cmim me të lartë në krahasim me OE-fitues.

-Diploma e prezantuar nga une personalisht Vllaznim Vuçitërna, është origjinali dhe e noterizuar dhe e vetmja që plotëson kriterin kryesor në tender në kuptim të plotësimit të kërkesave në të gjitha pikat e specifikave teknike të A.K. Në FTD është kërkuar gjeodet i diplomuar, dhe në kemi dorëzuar diplomën e gjeodetit. Sikur të ishte kërkesa gjeodet me titull ose kualifikimin "inxhinier i diplomuar i gjeodezisë", atëherë do të ishte krejt tjetër kërkesë, pasi që do të ceket titulli i diplomës dhe arsyeja do të qendronte, por me këtë rast, kërkesa ka qenë një gjeodet i diplomuar dhe nuk ka qenë kërkesa e kufizuar për diplomë të këtij lloji por vetëm të jetë i diplomuar, prandaj ajo pranohet si e tillë pasi që diploma është dhe gjeodeti është i diplomuar. Prandaj, me këtë rast ju keni bërë shkelje të dyfishtë për faktin se për tenderin e njëjtit herë e kaluar në hapjen e datës 06.03.2023 me nr 210-23-858-1-2-1 ka qenë po kjo diplomë si dhe ka qenë në rregull.

-Në FTD është kërkuar garancion nga prodhuesi ose dilleri i autorizuar sipas kushteve të fabrikimit, me këtë rast në kemi dorëzuar garancionin e tillë dhe është plotësisht konform kërkesave. Në garancion shkruan pjesa elektrike që ka kuptimin e makines-aircraft pasi që komplet struktura është e ndërtuar mbi elektrike dhe e ka atë kuptim, ndërsa pjesa e baterisë nuk ka të bëjë brenda dronit, çdo pjesë e tij është me chip dhe instalim elektrik, pra nuk ka mekanike dhe hidraulike aty. Për këtë keni mundur të kerkoni edhe sqarim shtesë dhe nuk do të ishte fundi i botes pasi që ligji e lejon sqarimin e dokumentit të dorëzuar, edhe pse në kemi pasur Autorizim për dorëzim të këtij tenderi.

Përgjigje ne pretendimin 1 te OE:

Sa i perkete pretendimit tuaj lidhur me Kerkesen se OE duhet te kete Staf nje Gjeograf ose Gjeodet te diplomuar ose master, AK ka vleresuar se ju nuk e keni permbushur kete kerkese pasi qe keni ofruar Gjeodetin vetem me Bachelor te Gjeodezise por jo gjeodet i diplomuar sic ka qene ne kerkese te AK-se.

Ndersa, lidhur me kerkesen e Akose se OE duhet te ofroje nje garancion nga prodhuesi apo dileri i autorizuar, ju nuk keni arritur te permbushni kete kerkese pasi qe nuk keni ofruar nje garancion të plotë për DRONIN nga prodhuesi apo dileri i autorizuar sic ka qene kerkese e AK-se.

Andaj, ky pretendim eshte i pabazuar dhe si i till refuzohet nga ana e AK-se.

Pretendimi 2:

- Arsyetimi se kemi cmimin me te larte ne krahasim me OE fitues, tregon favorizimin tuaj direkt te nje OE komplet te papergjegjshem i cili ne vazhdimesi ju ka vene ne lajthim dhe mashtrim, gje e cila edhe denohet penalisht pasi qe e ka shkelur deklaraten nen betim, prandaj me poshte si vijon do te sqarojme tutje si ka bere mashtrim:

-Ne hapjen e dates 06.03.2023 me nr **210-23-858-1-2-1** OE fitues ka prezantuar referenca nga persona fizik Alban Ejupi (person krejtesisht jashte lemise, si me ble naj qytetar i thjeshte nje bankomat per shtepi ose nje aparat per rezonance ose ngjajshem, privatisht ne shtepi!) dhe Agon Blakaj (referenca te cilat i kemi kontestuar ne dhe kemi kerkuar nga ju ti verifikoni dhe te kerkoni dokumente plotesuese transfer bankar ose fature te rregullt tatimore me fletedergese), por ju nuk keni vepruar dhe keni injoruar teresiht kerkesen tone per kete), me pas i njeiti OE ne kete tender ne hapjen e dates 17.07.2023 me nr. **210-23-6493-1-2-1** me qellim humbjes se gjurmeve, i largon keto referenca nga lista e kontratave te prezantuara dhe shpallet fitues i pergjegjshem edhe pse ka manipuluar me letra.Shtrohet pyetja pse i ka larguar ato, meqenese na qenkan te verteta.

-Njekohesisht, kerkojme qe te plotesohet referenca e Arsim Kastrati (person fizik jashte lemise se kerkuar) me fature te rregullt tatimore dhe fletetransfere bankar, ne menyre qe trajtimi te jete dinjitoz dhe i barabarte dhe "ferplay" ashtu siq garantojne ligjet dhe Kushtetuta e Republikes se Kosoves, ne te kunderten ne do te kerkojme sqarime shtese nga Administrata Tatimore e Kosoves, nese nje shitje e tille eshte e regjistruar.

-Paradoksale eshte kur urdherin e blerjes nga Autoriteti PK e prezanton si reference, ndersa ka bashkangjitur profature per mallin e liferuar!! Eshte hera e pare te shohim se nje Autoritet Publik, e ne veqanti siq eshte PK te kerkoje profature per pagese avans per mallin qe i eshte kerkuar te liferoj nga data 31/05/2023 deri me 28/08/2023, pra a e kuptoni, njehere pagese avans, me pas liferimin e mallit!! Meqenese kontrata eshte kornize dhe afatin e realizimit e ka deri me 2024, ajo nuk duhet te pranohet fare si e realizuar pasi qe nuk eshte finalizuar ne teresi ende dhe nuk reference se eshte perfunduar.

Ndersa referenca e leshuar nga Alban Sinani, nuk hyn fare ne kete kategori, pasi qe eshte furnizim krejtesisht tjeter me ate qe kerkohet me kete tender.

-Ne shkresen e dates 26.07.2023 ju si AK i kerkoni OE GJEO-PROJEKT SH.P.K. te dorezoj nje dokument i cili eshte dashur te dorezohet para hapjes, ndersa ju ne cilesine e sqarimit shtese i tregoni se mungese e ka dokumentit dhe i kerkoni ta dorezoj, kjo eshte ne kundershtrim me LPP. Ndersa me pas ai perseri nuk e percjell katalogun e nenvizuar te cdo pozicioni ashtu siq eshte kerkuar me FTD por e percjell nje katalog pershkrim copy-paste nga interneti (gje te cilen e kuptojme, pasi qe nuk ka kapacitet profesional te identifikoj sakte cdo pozicion te dronit

Matrice 300, pasi që është hera e parë si e shehe ketu në tender). Ndërsa me FTD ka qenë e cekur në mënyrë decitive se duhet të dorëzohet katalog i nënvizuar për çdo pozicion të kërkuar sipas Specifikave Teknike.

-Sipas specifikave teknike OE fitues nga ju, nuk ka arritur të dëshmojë-nëvizoj me katalog të nënvizuar: saktësinë e pozicionimit RTK me kompatibilitet me baze D-RTK2, nuk ka arritur të dëshmojë AirtSense sistemin për identifikim të aeroplanëve të tjerë, nuk ka arritur të dëshmojë rezolucionin e fotografive, nuk ka arritur të dëshmojë kendin e pamjes, nuk ka arritur të dëshmojë drejtimet 6 aksesh, nuk ka arritur të dëshmojë advanced dual operator mode ADC,

Përgjigje në pretendimin 2:

Sa i përket pretendimit tuaj lidhur me çmimin me të lartë, ju kujtojmë se AK nuk ka manipuluar në këtë rast e as në ndonjë rast tjetër, kjo pasi që shumë lehtë vërtetohet edhe me procesverbalin e hapjes që tani është gjithëkrah në mënyrë elektronike.

Nëse si AK, nuk kemi bërë vlerësimin e ofertave duke u bazuar në proceset e tenderimit të kaluar dhe nuk kemi qenë të detyruar apo edhe të obliguar që të bëjmë krahasimin e ofertave paraprake, por vetëm në Ritender janë vlerësuar dokumentacionet e dorëzuara nga të gjithë OE, pasi që janë dy procese të ndara, gjë që ky pretendim i juaj është i pa arsyeshëm dhe jo relevant.

Gjithashtu, pretendimi juaj lidhur me referencat e OE nuk qëndron pasi që OE ka prezantuar kontrata dhe referencat sipas kërkesës së AK-së, duke e plotësuar edhe këtë kriter. Ndërsa lidhur me dyshimet tuaja për Autoritetin tjetër, ne ju njoftojmë se nuk jemi kompetent që të analizojmë dhe të gjejmë gabimet e tyre nëse ato janë, edhe pse ne besojmë se AK sic është Policia e Kosovës janë institucion kredibil dhe njeherit mendojmë se të gjitha verpimet e kryera në kuadër të asaj kontrate janë konforme kushteve të caktuara në kontratën e prezantuar. Andaj, ky pretendim i juaj nuk qëndron dhe është teresisht jo relevant me procedurën tonë.

Sa i përket pretendimit tuaj, lidhur me sqarimet e kërkuara nga AK për OE, ju njoftojmë se komisioni në mënyrë që të bëjë blerësimin korrekt dhe të duhur ka vepruar conform nenit 70 të LPP-së, ku OE vetëm ka sqaruar kërkesën dhe nuk ka pasur nevojë që të dorëzojë dokument shtesë.

Gjithashtu tek pretendimi juaj se nuk janë nënvizuar ju njoftojmë se OE fitues specifikat që i kemi kërkuar i ka kufizuar me katërkëndësh ngjyrë të kuqe.

Pretendimi 3: OE:

nuk ka arritur të dëshmojë AirtSense ADS-B Reciever.
Nuk ka arritur të dëshmojë aksesoret e nevojshëm për këtë dron.

-Te përshkrimi i cmimeve, nuk është plotësuar në rregull pasi që të kolona ku duhet të shkruhet përqindja e vlerës së TVSH %, ka shkruar vlerën prej 4240.68, e nëse njësia për TVSH shumëzohet me këtë përqindje, del se shuma totale me TVSH është 999,075.37, shumë e cila automatikisht e diskualifikon OE të shpallur fitues. të pranohet si në rregull do të duhej të shkruhej 18, pasi që norma tatimore e TVSH në RKS është 18 %.

Me këte rast nese e marrim per baze kerkesen e DT dhe ST, i vetmi OE qe ploteson kerkesat FDT dhe specifikave teknike jemi ne per faktin se kemi prezantuar dokumente te cilat permbushin 100% kerkesat e DT, perkatesisht ST-Specifikave Teknike, si dhe kemi prezantuar gjeodetin-trajnerin me referenca konkrete dhe fiks te prodhuesit DJI si dhe kemi prezantuar shitje fiks te serise se kerkuar DJI Matrice 300 me D-RTK dhe Dig Terra. Prandaj nese behet ekzaminimi, vleresimi dhe maten ne peshore ofertat e prezantuara, ateherë e vetmja oferte serioze dhe e cila i ploteson kerkesat e DT , FDT dhe ST jemi ne.

Gjithashtu ne si operator ekonomik e kemi ofruar deklaratën ku e konfirmojmë pranimin e specifikimeve teknike, dhe njëkohësisht kemi dorëzuar të gjithë dokumentacionin e prodhuesit, prandaj rezulton se ne i kemi plotësuar kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë dhe jemi të vetmit të përgjegjshëm ne kuptim te kesaj dosje te tenderit.

Se si janë formuluar kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, është përgjegjësi e autoritetit kontraktues, mirëpo ne, ashtu siç është kërkuar i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Përfundimisht ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, sipas nenit 60 të LPP-së dhe poashtu jemi diskriminuar në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.

Duke pasur parasysh nenin 1, 6 dhe 99 të LPP-së dhe Rregulloren e Punes 01/2020 Neni 4-plotesim i nenit 32, ju si autoritet kontraktues është dashur ti shfrytëzoni të gjitha dispozitat e LPP-së, edhe nëse keni pasur nevojë për sqarime shtesë është dashur të shfrytëzohen nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së, për të ardhur në një përfundim të saktë dhe real, sidomos kur kemi parasysh çmimin tonë të ofruar dhe mundësinë e ruajtjes së fondeve publike në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, e dihet se ju si autoritet kontraktues jeni të thirrur për të shfrytëzuar fondet në mënyrë racionale, ekonomike, efikase dhe duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Pergjigje ne pretendimin 3:

Lidhur pershkrimin e cmimeve , ju sigurojm se OE ka plotesuar sic duhet paramasen, pasi qe tek kolona ku eshte kerkuar TVSH, OE ka vendosur cmimin pa TVSH sic eshte kerkuar, duke e llogaritur me TVSH prej 18%, gje qe edhe pas llogaritjes nga ana e jone del te jete e sakt, njeherit ju kujtojme se edhe pot e ishte ndonje gabim aritmetik tek pjesa e TVSH-se, LPP e lejon qe AK te kalkuloje vete ate ne baze te shumes se caktuar prej 18%. Andaj, ky pretendim I juaji eshte I pabazuar dhe rrjedhimisht refuzohet.

Ndersa per pikat ne pretendimin tuaj, ku ju keni thene se I plotesoni , ju rikutojme se ju nuk jeni eliminuar per ato pika, andaj ky pretendim eshte jo relevant.

Njeherit ju informojm se ju keni pasur çmimin me te larte ne krahasim me OE te rekomanduar per kontrate.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit publik ka vepruar në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, andaj në si Autoritet Kontraktues i kundërshtojmë pretendimet e palës ankimore, me të cilën Operatori Ekonomik supozon se janë bërë shkelje të dispozitave të Ligjit për Prokurim Publik:

Andaj, konsiderojmë se Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës – Divizioni i Prokurimit, ka plotësuar të gjitha kriteret e vendosura në dosjen e tenderit, konform Rregullave dhe Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, mbi përcaktimin e kriterëve në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

Nga se u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshille juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankese brenda 10 dite pranë OSHP-së, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

- 1 1 X 1 AGEO & CO SH.P.K., L.Spitali Muharrem Fejza, Prishtine
- 2 1 X 1 OE Pjesëmarrës;
- 3 1 X 1 Arkivit të MMPHL.




INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE ankues është palë me interes sipas Nenit 4.1.26 të LPP-së.

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

	<div><div>REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA</div><div>ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI</div><div>Nr./Br. 180/23</div><div>Data/Datum 26.05.2023</div><div>PRISHTINË - PRIŠTINA</div><div>Republika e Kosovës</div><div>Republika Kosova – Republic of Kosovo</div><div>ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT</div><div>TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE</div><div>PROCUREMENT REVIEW BODY</div><div>Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (Ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë Tel: + 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net</div></div> <td></td>	
<p>PSH. Nr. 174 Dhe Nr.180/23</p> <p>Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (LPP), në përbërje nga Vjosa Gradinaj Mexhuani-Kryetare, Agon Ramadani-Referues dhe Vedat Poterqoi-Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) "Ageo & Co ShPK" Prishtinë dhe Operatori Ekonomik "Gjeo-Projekt" ShPK, Prishtinë, ushtruar kundër Vendimit të autoritetit kontraktues të datës 15.03.2023 për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Blerja e pajisjeve teknike - Dron" me numër të prokurimit 210-23-858-1-2-1, iniciuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor në cilësinë e Autoriteti Kontraktues (AK) me 26.05.2023 mori këtë:</p>		
<p style="text-align: center;">V E N D I M</p> <p>1. Aprovohen pjesërisht si të bazuara, ankesa e OE "Ageo&Co ShPK" e parashtruar në OSHP me 30.03.2023 (Protokolli 174/23) dhe ankesa e OE "Gjeo-Projekt" ShPK e parashtruar në OSHP me 01.04.2023 (Protokolli 180/2023), kurse Vendimi i AK i datës 15.03.2023 dhe aktiviteti i prokurimit "Blerja e pajisjeve teknike-Dron" numër prokurimi 210-23-858-1-2-1, anulohen në tërësi në mungesë të ofertave të përgjegjshme.</p> <p>2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj OSHP për gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit (i përshkruar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi) në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të LPP.</p> <p>3. Lejohet në emër dhe për llogari të ankuesve, kthimi i shumave të deponuara në emrin e tarifës ankimore, konform 131 të LPP, lidhur me nenin 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP.</p>		
<p>Shih edhe dokumentin:</p> <p>RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES Nr.2023/0174, i dates 18.04.2023</p>		

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - AGEO & CO SH.P.K.

OE ankues pretendon që AK e ka eliminuar atë pa të drejtë dhe ka shpallur fitues një OE që nuk është i përgjegjshëm. Teskti i plotë i pretendimeve të OE ankues është prezantuar në sesionin 2 të këtij raporti, andaj këtu do t'i referehohemi atyre për aq sa është e nevojshme.

Pretendimi 1

OE ankues pretendon që me ofertën e tyre e ka përmbushur kërkesën e tenderit: *"OE duhet të ketë staf një Gjeograf ose Gjeodet të diplomuar ose master, te kete pervoje pune se paku 3 vite pas diplomimi,* duke prezantuar diplomën e Vllaznim Vuçitërns. OE ankues ka argumentuar që kërkesa e DT nuk e ka specifikuar që gjeodeti duhet të jetë "inxhinier i diplomuar i gjeodezisë", prandaj diploma e paraqitur nga OE ankues është në përputhje me kërkesën në fjalë.

Duke qenë se kjo çështje është trajtuar edhe në Raportin e Ekspertit me Nr.2023/0174, të datës 18.04.2023, ku është theksuar që "z.Vllaznim Vuçitërna ka kualifikim shkollor sipas kërkesës së përcaktuar nga AK", eksperti shqyrtues konsideron që ky pretendim i OE ankues është i bazuar.



Pretendimi 2

OE ankues pretendon që garancioni i paraqitur nga ai me ofertë i plotëson kërkesat e DT. Sipas OE ankues edhe pajisja dhe garancioni i paraqitur nga OE i rekomanduar për kontratë është nga i njëjti prodhues dhe diler.

Eksperti shqyrtues i ka ekzaminuar të dy dokumentet (që janë paraqitur më poshtë) dhe siç mund të

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtuar nga OE “**AGEO & CO SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Ri-tender Blerja e paisjeve teknike - Dron**” me numër të prokurimit: “**210-23-6493-1-2-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor**

shihet ato janë lëshuar nga e njëjta kompani nga Kroacia “**AVITEH**”. Në të dyja rastet kompania ka ofruar garancionin e njejtë për produktet e saj, pra 24 muaj për pjesët elektrike, ndërsa 12 muaj për bateri.



AVITEH Audio Video Tehnologije d.o.o.
ul. Matka Baštijana 41, 10000 Zagreb, Hrvatska
info@aviteh.hr • www.aviteh.hr

FROM:

AVITEH Audio Video Tehnologije d.o.o.
ul. Matka Baštijana 41
10000 Zagreb
OIB: 74228338976

TO:

Gjeo-Projekt SH.P.K
Rr.UÇK-së, pn
21000 Rahovec

DJI Warranty

Company AVITEH Audio Video Tehnologije d.o.o., as official dealer for DJI drones and equipment, confirms warranty periods for next DJI products:

DJI Matrice 300 system (excluding batteries) - 24 months
DJI TB60 and WB37 batteries - 12 months.

In Zagreb, 13.07.2023.

AVITEH
Audio Video Tehnologije d.o.o.
ZAGREB, OIB: 74228338976

AVITEH Audio Video Tehnologije d.o.o., ul. Matka Baštijana 41, 10020 Zagreb, Tel.: +385 1 889 5552
IBAN: HR2223600001102294879, OIB: 74228338976

Društvo je upisano u Registar Trgovačkog suda u Zagrebu pod brojem Tt-15/18517-1, MBS 080805145
Temeljni kapital društva iznosi 20.000,00 kuna i uplaćen je u cijelosti.



AVITEH Audio Video Tehnologije d.o.o.
Ulica Matka Baštijana 41, 10000 Zagreb, Hrvatska
info@aviteh.hr • www.aviteh.hr

Warranty Period

We AVITEH Audio Video Tehnologije d.o.o. with OIB: 74228338976, with address Bastijanova 41, 10 000 Zagreb, Croatia hereby declare that warranty for offered DJI product is:

24 months for all electrical parts, except batteries which are 12 months

Marko Arsenovic, Head of Sale

AVITEH Audio Video Tehnologije d.o.o.

Tel: +385 1 2100 402
Mob: +385 99 3645 409
Mail: marko@aviteh.hr
Web: www.aviteh.hr

Zagreb, Croatia; date: 01.03.2023

AVITEH
Audio Video Tehnologije d.o.o.
ZAGREB, OIB: 74228338976



AVITEH Audio Video Tehnologije d.o.o.
Ulica Matka Baštijana 41, 10000 Zagreb, Hrvatska
info@aviteh.hr • www.aviteh.hr

AUTHORIZATION CERTIFICATE

We AVITEH Audio Video Tehnologije d.o.o. with OIB: 74228338976, with address Bastijanova 41, 10 000 Zagreb, Croatia hereby declare that AGEO & CO SH.P.K. With NUI 810840620 represented by Villaznim Vuçitërna-Menager with address L. e Spitalit, Muharrem Fejza Prishtine 10 000 Kosovo is our Authorized Dealer and Service Center in Kosovo. The product range includes DJI Drones and the related surveying accessories.

They have the complete ability and authority to participate in all government or private tender and sales, to bid, to negotiate, to sign contracts, to sell, to service and apply for any necessary approvals and permissions on our behalf as our authorized dealer of DJI Drones.

Marko Arsenovic, Head of Sale

AVITEH Audio Video Tehnologije d.o.o.

Tel: +385 1 2100 402
Mob: +385 99 3645 409
Mail: marko@aviteh.hr
Web: www.aviteh.hr

Zagreb, Croatia; date: 01.03.2023

AVITEH
Audio Video Tehnologije d.o.o.
ZAGREB, OIB: 74228338976

Ekspteri shqyrtues vlerëson që edhe ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi 3

OE ankues pretendon që disa prej referencave të dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë nuk i përmbushin kërkesat e DT. Specifikisht, OE ankues ka kontestuar vlefshmërinë e dokumenteve të prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë për furnizimet për Policinë e Kosovës (81,180 Euro), Arsim Kastrati (15,150 Euro) dhe Alban Sinani (2,000 Euro).

Duke pasur parasysh kërkesat e DT si më poshtë, nga ekzaminimi i shkresave relevante, eksperti shqyrtues vlerëson që dokumenti i paraqitur në lidhje me projektin **Furnizim me drona** në vlerë prej 81,180 Euro, me AK Policia e Kosovës, nuk mund të konsiderohet plotësisht në përputhje me kërkesat e DT, pasi që kërkesa në fjalë ka qenë që *“OE duhet të ofroj dëshmi se gjatë tri viteve të fundit, deri në njoftimin për kontratë, ka kryer me sukses furnizime të natyrës së ngjajshme [...]”* dhe një gjë e tillë të dëshmohet me *“kopjen e referencave ose procesverbaleve të pranimit përfundimtar të furnizimeve [...]”*. Meqenëse një kontratë e tillë është në implementim e sipër, OE i rekomanduar për kontratë e ka të pamundur të paraqesë *“referenca”* ose *“procesverbale të pranimit përfundimtar të furnizimeve”*, siç kërkohet me DT. Sidoqoftë, AK do të mund të konfirmonte me Policinë e Kosovës vlerën e saktë të furnizimeve, deri në njoftimin për kontratë; dhe të kërkonte një vlerësim për integritetin e furnizuesit, në këtë rast OE të rekomanduar për kontratë. Në të kundërtën, në mungesë të një dëshmie të tillë mund të konstatohet që OE nuk e ka përmbushur kërkesën përkatëse të DT.

Po ashtu, furnizimet e bëra për Alban Sinanin, për projektin **Furnizim me instrument gjeodezik Leica 1103 plus dhe aksesorët shtesë**, me vlerë prej 2,000 Euro, nuk duket të jenë të “natyrës së ngjajshme”.

	Kapaciteti teknik dhe profesional	Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2	Operatori ekonomik duhet te ofroj dëshmi se gjate tri viteve te fundit deri ne njoftimin per kontrate ka kryer me sukses furnizime të natyrës së ngjajshme, ne vlere jo me te vogel se 63,000.00 euro.	Operatori ekonomik duhet te ofroje listen e kontratave të ngjajshme të realizuara gjatë tri viteve të fundit deri në njoftimin per kontrate. E dëshmuar me kopjen e referencave ose procesverbalet e pranimit përfundimtar të furnizimeve duke treguar vlerën , datën, dhe vendodhjen e projekteve të furnizimeve në lëmin e kërkuar ne vlere jo me te vogel se 63,000.00 euro. Lista duhet te dorezohet ne origjinal e nenshkruar dhe vulosur nga operatori ekonomik.

Rrjedhimisht, vlerësoj që ky pretendim i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi 4

Pretendimi tjetër i OE ankues është që AK e ka shkelur LPP duke i kërkuar OE të rekomanduar për kontratë katalogun, pas hapjes së ofertave.

Sipas Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurim Publik, kërkesa për dorëzim të katalogut nuk është në kundërshtim me LPP. Sipas udhëzimeve të ofruara në këtë akt, tek pjesa 10. **Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve**, AK mund të kërkoj informata sqaruese në rastet kur mungon katalogu.

Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-së
Është dorëzuar specifikacioni teknike për mallrat e ofruara por mungon katalogu	Mund të kërkojen informata sqaruese	69

Sidoqoftë nga rishikimi i dëshmisë së ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë, nuk kam hasur në nënvizimet me ngjyrë për pajisjen e kërkuar, siç është specifikuar në kërkesat e DT, më poshtë.

	Kapaciteti teknik dhe profesional	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2	OE duhet të dorëzojë katalog për komisionin e vlerësimit dhe në pjesen e katalogut duhet të ketë të nënvizuar me ngjyrë për paisjen e kërkuar sipas kërkesës së AK.	OE duhet të dorëzojë katalog për komisionin e vlerësimit dhe në pjesen e katalogut duhet të ketë të nënvizuar me ngjyrë për paisjen e kërkuar.(origjinal jo kopje nga inetrneti)

Rrjedhimisht, konsideroj që ky pretendim i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi 5

Për sa i përket pretendimit për gabimin e OE të rekomanduar për kontratë tek forma e pershkrimit të çmimeve, me ç’rast tek kolona e TVSH-së është paraqitur vlera në vend të %, konsideroj që përgjigjja e dhënë nga AK është e arsyeshme dhe ky pretendim është i pabazuar.

PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

NR. I ART	PËRSHKRIMI	NJESIA MATESE	SASIA	ÇMIMI PËR NJESI PA TVSH€	TVSH (%)	ÇMIMI PËR NJESI ME TVSH€	ÇMIMI TOTAL ME TVSH€	VENDI ORIGINES
1	Furnizim me dorn dhe Trajnimi i zyrtarit Për perdorim (procedurën e punës)	cope	1	23,559.32	4240.68	27,800.00	27,800.00	KINA
2								
ÇMIMI TOTAL ME TVSH							27,800.00€	

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE

ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, rekomandohet të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “AGEO & CO SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Ri-tender Blerja e paisjeve teknike - Dron**” me numër të prokurimit: “210-23-6493-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **AGEO & CO SH.P.K.**

Ilir Salihu

